

V E N D I M
Nr.81, datë 26.2.1993

**PËR KRIJIMIN E GRUPIT BASHKËRENDUES TË PUNËS PËR SISTEMIN E
REGJISTRIMIT TË PRONËS SË TOKËS**

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Krijimin e grupit bashkërendues të punës për sistemin e regjistrimit të pronësisë së tokës prej 11 vetash me specialistë nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Instituti i Studimit të Tokave dhe Instituti Topografik i Ushtrisë.

2. Grupi ka për qëllim të bashkërendojë krijimin e një sistemi të regjistrimit të pronësisë së tokës, i cili do të sanksionojë dhe do të mbrojë pasurinë shtetërore e private të tokës.

3. Detyrat e këtij grupi janë:

a) Të përgatitë kërkesat për legjislacionin dhe rregullime të nevojshme për regjistrimin, paraqitjen dhe mbrojtjen e të drejtave mbi pasurinë shtetërore e private mbi tokën, si dhe pasurinë e paluajtshme të ngritur mbi të.

b) Të bashkërendojë veprimtarinë e agjencive të ndryshme, të nevojshme për krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të regjistrimit të pronësisë së tokës.

c) Të përcaktojë strukturën organizative dhe procedurat e regjistrimit në secilin rreth, formatin e përdorur për regjistrimin e të drejtave mbi tokën, ndërtesat, kullotat dhe pyjet, si dhe personelin, mjediset e zyrave dhe pajisjet e nevojshme për çdo regjistër.

ç) Të përgatitë planin e veprimit për krijimin e regjistrave përkatës në secilin rreth. Në këtë plan do të përfshihen pajisjet, personeli, kualifikimi, transporti dhe materialet që duhet të përdoren për një kohë të caktuar, për krijimin e hartave të pasurisë së tokës, për regjistrimin e të drejtave mbi pasurinë në secilin rreth dhe për mirëmbajtjen e sistemit të regjistrimit të pronësisë së tokës si një pasqyrim i saktë i të drejtave aktuale mbi pasurinë.

d) Të përcaktojë standardet për prodhimin dhe mirëmbajtjen e hartave të parcelave të tokës, që janë pronë e njësive shtetërore dhe private. Nje parcelë toke përcaktohet si një copë toke e kufizuar që ka një pronar i caktuar.

dh) Të përcaktojë kalendarin e takimeve dhe detyrat e çdo autori të grupit.

4. Për zgjidhjen e problemeve teknike grupi ka të drejtë të krijojë nëngrupe të veçanta ekspertësh.

5. Deri në institucionalizimin e sistemit të regjistrimit të pronësisë, grupi drejtohet nga zëvendësministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, i cili miraton përbërjen e tij.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit. Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe Ministria e Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi